



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2019:263783

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05542991

**P.nr.75/2019**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Novobërd**, gjyqtari Sadri Krasniqi, me zyrtaren ligjore Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të pandehurve: F.P. nga fsh.Busavatë, për shkak të veprës penale, vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së dhe F.B. nga Prishtina, për shkak të veprës penale, Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të fituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333, paragrafi 2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1740/2019 të datës 13.11.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar më 11.03.2024, në prani të palëve, shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 04.04.2024, përpiloi këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**T ë p a n d e h u r i t :**

**1.F.P.**, pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm, nga i ati F. dhe ëma H. e lindur G., i lindur më datë 27.11.1997, në Gjilan, me vendbanim në fshatin Busavatë, Komuna e Kamenicës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.pesonal ..... i pa martuar, i pa punësuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes të varfër ekonomike, sipas deklaratës së tij ka qenë i dënuar më parë për vepër tjetër penale dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale, me nr.kontaktue 0./...-....dhe

**2.F.B.**, pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm, nga i ati I. dhe ëma H. e lindur Sh., i lindur më datë 21.02.1992, në Dabishevc, me vendbanim në Prishtinë, rr. "Kongresi i Elbasanit", nr.20, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal. ... i martuar, prind i tre fëmijëve, i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes të varfër ekonomike, sipas

deklaratës së tij i pa dënuar më parë për veprë tjetër penale dhe udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale, me nr. kontaktues 0./...-....

## **Janë fajtorë**

Sepse:

### **I pandehuri F. P.,**

#### **I.**

Më datë 03.09.2019, në pyllin në mes fshatit Jesenovik dhe Bolevc të Komunës së Novobërdës, në vendin e quajtur Baqevishtë gjegjësisht te “Ara e Draganit”, të pandehurit P. M. dhe F. P. me qëllim vjedhje, në pyllin e pronësisë së të dëmtuarit J. S. Zh., me sharrë motorike ka prerë 8.40 metra<sup>3</sup> dru të njoma të Bungut të cilat ia kanë shitur F. B., me çka të dëmtuarit J. i kanë shkaktuar dëm në shumë të pa përcaktuar.

-me çka ka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

### **I pandehuri, F.B.,**

#### **II.**

Më datë 03.09.2029, në pyllin në mes fshatit Jesenovik dhe Bolevc të Komunës së Novobërdës, i pandehuri F.B. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm blen drutë e përfituara me veprë penale në sasi prej 8.40 m<sup>3</sup> dru të njoma Bungu, me çka të dëmtuarit J. i është shkaktuar dëm në shumë të pa përcaktuar,

-me çka ka kryer veprën penale, Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve të lartcekura dhe neneve 4, 38, 40, 42, 43, 44, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 72, parag. 1, nën parag.1.7 të KPRK-së, lidhur me nenet 242, 364, 359, paragrafi 2 dhe 452 të KPRK-së, të pandehurit, i

## **G J Y K O N**

1. Të pandehurin **F. P.**, për veprën penale si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, me dënim me **gjobë** ( të holla) në shumë prej **300 € (tre qind euro)**, të cilën shumë ka për ta paguar, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, **në tri këste**

**mujore**, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burgu dhe

- Me dënim **me burgim** në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në rast se i akuzuari kryen vepër tjetër penale, brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg.

**2.** Të pandehurin **F.B.**, për veprën penale të përshkruar si në pikën **II.** të dispozitivit të aktgjykimit, me dënim me gjobë ( të holla) në shumë prej **300 € (tre qind euro)**, të cilën shumë ka për ta paguar, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, **në tri këste mujore**, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burgu.

I dëmtuari Zh. J. nga fsh.Jasenovik, komuna e Novobërdës nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë Pasurore juridike.

Detyrohen të pandehurit, që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtojnë shumën prej nga 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu të pandehurit detyrohen që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të arkëtojnë shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.1740/2019 të datës 13.11.2019, ka kërkuar që ndaj të pandehurve, F. P. nga fsh.Busavatë, për shkak të veprës penale, vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së dhe F. B. nga Prishtina, për shkak të veprës penale, Blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të fituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333, paragrafi 1 të KPRK-së, të fillohet dhe zhvillohet procedura penale, të njëjtit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndëve konstatoi se aktakuza është e bazuara në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të pandehurve për datën 18.03.2024, në të cilën seancë gjyqësore, ftesës së gjykatës ia janë përgjigjur të pandehurit F. P. dhe F. B.,

ndërsa ka munguar i pandehuri tjetër P. M., ku sipas konstatimit të policisë, i njëjti ndodhet me punë në Gjermani. Në fillim të kësaj seance gjyqësore, të pandehurit F. P. dhe F. B., me qëllim të mos zvarritjes së procedurës penale ndaj tyre, i propozuan gjykatës, që ndaj të pandehurit P. M., të veçohet procedura penale, të cilin propozim nuk e kundërshton prokurorja e shtetit. Gjykata duke vepruar sipas propozimit të të pandehurve F. P. dhe F. B., e duke pasur parasysh se i pandehuri P. M. ndodhej në botën e jashtme dhe për momentin është i pa kapshëm për gjykatën dhe për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës penale, e me qëllim të mos zvarritjes së procedurës ndaj këtyre dy të pandehurve, në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 35 të KPPRK-së, me Aktvendim e ka veçuar procedurën penale ndaj të pandehurit P. M. nga fsh.Busavatë, komuna e Kamenicës, e cila procedurë ndaj të njëjtit në të ardhmen do të zhvillohet dhe përfundohet ndaras me vendim të veçantë, pranë kësaj gjykate. Në të cilën seancë gjyqësore, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, të pandehurit F. P. dhe F.B. deklarojnë se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprat penale me të cilat akuzohen, njëherit deklarojnë se e pranojnë fajësinë për kryerjen e këtyre veprave penale.

Prokurorja shtetit Huma Jetishi nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, njëherit thekson se janë plotësuar kushtet për pranimin e fajësisë nga të pandehurit, lidhur me këto vepra penale të cilat i vihen në barrë sipas akteve akuzuese.

Gjykata pas dëgjimit të palëve në procedurë ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë nga të njëjtit është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i pandehuri F. P., në kohën dhe vendin e cekur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me dashje, ka kryer veprën penale, vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ndërsa sa i përket të pandehurit F.R., gjykata duke pasur parasysh faktin se i njëjti gjatë seancës gjyqësore disa herë theksoj se nuk e ka ditur se drutë të cilat i kishte blerë prej të pandehurit P. M. kanë qenë dru të vjedhura, duke vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 359, paragrafi 2 të KPPRK-së, bëri rikualifikimin e veprës penale nga paragrafi 1, në paragrafin 2 të neni 333 të KPRK-së dhe konstatoj se i pandehuri F. R., në kohën dhe vendin e cekur si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ka kryer veprën penale, Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 paragrafi 2 të KPRK-së. Për të cilat vepra penale,

gjykata të pandehurit i shpalli fajtorë, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat janë edhe penalisht përgjegjës.

Pasi që të pandehurit e kanë pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuza, por drejtë është shkuar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokuroja e shtetit **Huma Jetishi**, me rastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare deklaron se në shqyrtimin e sotëm fillestar të pandehurit F. P. dhe F. B., e pranuan fajësinë për veprat penale të cilat iu vihen në barrë nga aktakuza, pranimin e fajësisë të njëjtit e bënë vullnetarisht pa ndikim të dhunës, me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës lëndore, me që u vërtetua gjendja faktike mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban, andaj kërkon nga gjykata që të pandehurit të shpallen fajtor dhe të njëjtit ti dënojë me dënime të parapara me ligj, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, në mënyrë që dënimet e shqiptuara të jenë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit Zh. J. me rastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare deklaron se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurve dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, pasi që i pandehuri F.B., ia ka kompensuar dëmin e shkaktuar, e po ashtu që të tre kanë shkuar te ai dhe i kanë kërkuar falje, kërkon nga gjykata që të njëjtit t'i liroj nga përgjegjësia penale sepse këtë e kanë bërë nga gjendja e vështirë ekonomike në të cilën jetojnë.

I pandehuri F. P. në fjalën përfundimtare deklaron se, e pranon fajësinë, ka gabuar, është penduar, të dëmtuarit i kërkon falje publike sepse nuk e ka ditur se është pronë private, por ka menduar se është pronë e shtetit, i premtun gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra apo të tjera penale. Të dëmtuarit së bashku edhe me F.ia kanë kompensuar dëmin andaj kërkon nga gjykata që mundësisht ti shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit, sepse jeton në kushte shumë të vështira ekonomike dhe nëse eventualisht më shqipton ndonjë dënim me burg të njëjtin dënim t'ia zëvendësojë në dënim me gjobë ose me kusht.

I pandehuri F.B. në fjalën përfundimtare deklaron se, e pranon fajësinë, ka gabuar, është penduar, i premtun gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra apo të tjera penale, se nuk e ka ditur se drunjtë që i ka blerë prej P. kanë qenë të vjedhura dhe kur e ka kuptuar që drunjtë kanë qenë të vjedhura, së bashku me P. dhe F. kanë shkuar te i dëmtuari dhe i kanë kërkuar

falje dhe ia kanë kompensuar dëmin. I vie keq për rastin që ka ndodhur dhe kërkon nga gjykata që të ketë parasysh gjendjen e tij të vështirë ekonomike në të cilën jeton, për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, në mënyrë që mundësish gjykatat ti shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit dhe nëse eventualisht i shqipton ndonjë dënim me burg të njëjtin dënim t'ia zëvendësojë në dënim me gjobë ose me kusht.

Gjykata me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të pandehurve për këto vepra penale të kryera, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Për këtë rast si rrethana lehtësuese për të pandehurit gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga të njëjtit, gjendjen e tyre të vështirë ekonomike në të cilën jetojnë, kanë gabuar dhe janë penduar thellë për veprat penale të kryera, i premtojnë gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejnë këso vepra apo të tjera penale. Po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese pati parasysh edhe faktin se të njëjtit të dëmtuarit ia kanë kompensuar dëmin dhe i kanë kërkuar falje dhe se i dëmtuari nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurve. Andaj gjykata duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprave penale të kryera dhe mënyrën e kryerjes së tyre, iu ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata, po ashtu vlerësoi se edhe me këto dënime, do të arrihet qëllimi i dënimit, si dhe do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të pandehurve që në të ardhmen të mos kryejnë vepra të këtillë apo të ngjashme penale.

I dëmtuari Zh. J. nga fsh.Jasenovik, komuna e Novobërdës nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurve dhe nuk parashtron kërkesë Pasurore juridike.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurve, gjykata, bazuar në nenin 452 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të pandehurit ti detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (Njëzetë euro), si dhe nga 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2019:263783, 04.04.2024**

**Gjyqtari**

---

Sadri Krasniqi, d.v.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.